

Eriola Bibolli

Znj. Eriola Bibolli është një drejtuese e lartë bankare me përvojë të gjerë në menaxhimin ekzekutiv dhe qeverisjen korporative në sektorin financiar, kryesisht brenda ProCredit Group. Ajo ka përfunduar studimet Bachelor në Administrim Biznesi dhe Ekonomi në Universitetin e Korçës dhe Master në Administrim Biznesi (MBA) në Universitetin Bradford/NIMBAS, në Mbretërinë e Bashkuar dhe Holandë. Gjithashtu, është e diplomuar në Akademinë ProCredit në Gjermani, një program i avancuar lidërshtipi për drejtues të lartë bankarë.

Karriera e saj profesionale është zhvilluar pothuajse tërësisht brenda ProCredit Group, ku ka mbajtur një gamë të gjerë pozicionesh të larta drejtuese me përgjegjësi në fushat e financave, kontrollit financiar, menaxhimit të rrezikut dhe drejtimit ekzekutiv. Ajo ka shërbyer si Kryeshefe Ekzekutive (CEO) e ProCredit Bank Kosovë, duke mbajtur më parë për më shumë se një dekadë pozicionin e Zëvendëskryeshefes Ekzekutive, si dhe role të tjera drejtuese si Drejtuese e Divizionit të Financave dhe Kontrollit dhe Menaxhere e Rrezikut.

Aktualisht, znj. Bibolli është Kryetare e Bordit Drejtues të ProCredit Holding dhe është pjesë e disa bordeve të bankave dhe entiteteve të ProCredit Group në vende të tjera. Ajo flet anglisht rrjedhshëm, ka njohuri pune në italisht dhe spanjisht, dhe është folëse amtare e gjuhës shqipe.